



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 152/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selajdin Bytyçi, kandidat i pavarur për Komunën e Malishevës, paraqitur kundër subjektit politik NISMA, dega në Malishevë, për shkak të dëmtimit të billbordave, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Selajdin Bytyçi kandidat i pavarur për Komunën e Malishevës, Anr.152/2017, e datës 09.10.2017, paraqitur kundër subjektit politik NISMA, dega në Malishevë.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.10.2017, nga Selajdin Bytyçi kandidat i pavarur për Komunën e Malishevës, paraqitur kundër subjektit politik NISMA dega në Malishevë, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik Nisma i ka dëmtuar billbordët e tij dhe se për këtë është e njoftuar edhe zyrtarja e KQZ-së në Malishevë si dhe Policia. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerësoi se pretendimet në ankesë janë të paqëndrueshme, për faktin se nga dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se kush ka dëmtuar billbordët, ashtu siç pretendon parashtruesi i ankesës. Andaj duke u nisur nga kjo, se dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk janë bindëse dhe të qarta siç kërkohen me nenin 117 par. 3 të LZP-së, paneli nuk ka mundur të vërtetoi se ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike mbështetësit dhe kandidatët, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 152/2017 i datës 12.10.2017



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.